

A photograph of a woman and a young girl. The woman, on the left, is smiling and looking towards the girl. The girl, on the right, is focused on drawing with a blue pencil. The image is framed by a large red circular graphic element.

**NDIHMOMJË FËMIJËT
TË MËSOJNË NË SHTËPI
UDHËZUES PËR PRINDËRIT**



Save the Children



Save the Children





FUSHAT E TË NXËNIT

01 ROLI I PRINDËRVE, VËLLEZERVE
DHE MOTRAVE NË PROMOVIMIN E
ZHVILLIMIT MATEMATIKOR

02 ROLI I PRINDËRVE, VËLLEZERVE
DHE MOTRAVE NË PROMOVIMIN E
ZHVILLIMIT GJUHËSOR

03 ROLI I PRINDËRVE, VËLLEZERVE
DHE MOTRAVE NË PROMOVIMIN E
AFTËSIVE PËR JETËN

04 ROLI I PRINDËRVE, VËLLEZERVE
DHE MOTRAVE NË PROMOVIMIN DHE
KRIJIMIN E RUTINAVE NË SHTËPI

01

ROLI I PRINDËRVE, VËLLEZËRVE DHE MOTRAVE NË PROMOVIMIN E ZHVILLIMIT MATEMATIKOR

VEPRIMTARIA

Ndarje dhe Klasifikim
(organizojmë objektet sipas
masës, ngjyrës, formës dhe
përbërjes)

Numërimi dhe shkrimi i
numrave

Krahasimi

Koncepti i numrit

Simboli i numrit

Format dhe hapësirat

Të dashur prindër, vëllezër ose motra,

- Merrni një kuti në të cilën mbani kopsa, kapakë shishesh, kube të vegjël, kartonë të prerë në formë katrore, fara, gurë të vegjël, etj
Fëmija do të argëtohet duke i ndarë në grupe sipas ngjyrës, madhësisë apo formës.
- Më pas kërkojini t'i ndajë në një mënyrë tjetër.
Kërkojini të gjejë çfarë ka bërë?

- Numërojmë gjithçka! Lëreni fëmijën të numërojë objekte të ndryshme në shtëpi, si: p.sh filxhanë, pjata, këpucë, fustanë, dyer, dritare, pula, rosa, apo kafshë të tjera
- Numëroni në rend rritës pastaj në rend zbritës. 1, 2, 3, 4, ... dhe pastaj 4, 3, 2, 1.
- Këndoni këngë duke numëruar. Për shembull:
Një elefant në një fije merimange kolovitet..... dhe kur e pa që nuk ra thirri një tjetër elefant.....
Dy elefantë në një fije merimange koloviten..... dhe kur e panë që nuk ranë thirrën një tjetër elefant.....
Kënga mund të vijojë duke shtuar numra derisa të keni dëshirë.
Bëni ushtrime gjimnastikore:
Ulu, ngrihu duke numëruar: 1-2-3-4-5

- Krahasoni numrin e objekteve që keni në shtëpi.
- Për shembull: Numrin e pjatave me numrin e pirunëve; numrin e karrigeve me numrin e tavolinave
- Krahasoni motin e mëngjesit të sotëm dhe ditës së djeshme;
- Tregoni histori rreth krahasimit.

- Numëroni me fëmijën numrin e pjatave, lugëve, batanijeve dhe sapunëve, që i duhen familjes

- Përdorni një shkop për të vizatuar së bashku me fëmijën, në rërë ose në dhe, objekte të ndryshme dhe një numër poshtë secilit objekt
Për shembull: Vizatoni sa pemë ka në oborr dhe shkruani numrin.

Zbavituni duke luajtur!

- Grumbulloni në: forma katrore, rrethore, trekëndore, drejtkëndore dhe vezake
- Në shtëpinë apo hapësirën ku banoni gjeni objekte që kanë forma katrore, rrethore, trekëndore, drejtkëndore dhe vezake.

A young girl with dark hair is shown in profile, speaking into a silver and black microphone. She is wearing a white long-sleeved shirt with a pink flower design. In the background, another child is visible, looking down at a piece of paper. The scene is set against a blurred background of other people and papers.

02

**ROLI I
PRINDËRVE,
VËLLEZËRVË
DHE MOTRAVE
NË PROMOVIMIN
E ZHVILLIMIT
GJUHËSOR**

VEPRIMTARIA

Të dashur prindër, vëllezër ose motra,

Bashkëbisedim mbi vizatimin

- Uluni me fëmijën dhe shihni vizatimin
- Modeloni një bashkëbisedim të mirë.
Për shembull: Unë shoh një vajzë të vogël në këtë vizatim. Po ti çfarë sheh?
- Nëse fëmija është i tërhequr, inkurajojeni duke i thënë: “E ke radhën ti për të thënë diçka. A mund të më thuash se çfarë shikon në vizatim?”

Lexim

- Lexojini fëmijës libra me figura të cilët keni mundësi t'i blini
- Bëni vetë një libër të thjeshtë në shtëpi duke përdorur materiale që keni në dispozicion. Librin mund ta bëni së bashku me fëmijën.
- Recitoni vjersha apo rima për fëmijë
- Tregoni gjëgjëza dhe poezi të shkurtra
- Krijoni së bashku fjali të shkurtra për situatën në të cilën gjendeni
- Vizatoni objekte të ndryshme me fëmijën

A close-up photograph of a young girl with her hair styled in two braids. She has a small pink heart sticker on her right cheek and is looking slightly to the right with a neutral expression. The background is blurred, showing other people in a room. The image is framed by a red border on the left and bottom.

03

**ROLI I
PRINDËRVE,
VËLLEZËRVE
DHE MOTRAVE
NË PROMOVIMIN
E AFTËSIVE PËR
JETËN**

Besim në vete

- Lëreni fëmijën të kujdeset për veten
- Vini re se cilat janë interesat dhe komentet e fëmijës.
- Jepni lëvdata të sinqerta dhe nga zemra për diçka që fëmija ka arritur të kryejë.
- Kërkojini t'ju ndihmojë me punët e shtëpisë duke e ngarkuar me detyra që janë sfiduese, por jo të vështira për përvojën e fëmijës, në mënyrë që t'i realizojë.
- Shmangni vënien në lojë apo fyerjen e fëmijës
- Kujtojini fëmijës që të gjithë bëjnë gabime. Gabimet na ndihmojnë të mësojmë.
- Ruajtja e rregullit në mjedisin dhe rutinën ditore i jep fëmijës siguri dhe qetësi. Gjithashtu i jep mundësinë të parashikojë veprimin vijues, të mësojë sesi të bëjë plane dhe të krijojë rutinën e tij për të mësuar dhe për të luajtur.
- Siguroni realizimin e detyrave dhe punëve në mënyrë të pavarur nga fëmija.
- Mësojini fëmijës se si të dallojë veprimet e përshtatshme nga pikëpamja morale.
- Mos i lejoni fëmijët të mbizotërojnë në çdo ndërveprim në familje, të lëndojnë veten apo familjarë të tjerë apo të prishin objekte të shtëpisë.
- Caktoni kufij. Tregojini fëmijës se çfarë pritshmëri keni dhe ndihmoheni t'i arrijë. Duke caktuar kufijtë, ju e ndihmoni fëmijën që të caktojë edhe kufijtë e tij.


Aftësi për vendimmarrje

- Praktikoni zgjidhjen e problemeve si një veprimtari në familje dhe shpjegoni arsyet përse të rriturit kanë marrë një vendim të caktuar.

<p>Aftësi për vendimmarrje</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Jepini fëmijës sa më shumë mundësi zgjedhjeje, por kufizojini që të jenë të pranueshme për ju. Ndhimoheni të mbrojnë vendimet e veta dhe të eksperimentojë me pasojat e zgjedhjeve që ka bërë. Duke pasur disa mundësi zgjedhjeje, fëmija zvogëlon luftën për pushtet dhe ndërton kompetenca. • Jepini fëmijës kohë për të luajtur.
<p>Marrëdhënie Përvetësimi i aftësive për përgjegjësi sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mësojini fëmijës të buzëqeshë dhe të përdorë si duhet kontaktin me sy • Përvetësimi i aftësive vlerat e duhura morale dhe kulturore • Modeloni sjelljet e mira • Mësojini fëmijës empatinë duke folur për ndjenjat tuaja dhe nxiteni të shpjegojë ndjenjat e veta si dhe të dallojë ndjenjat e të tjerëve • Ndhimoheni fëmijën të mësojë se si ti bashkohet një grupi, të ndajë, dhe të presë radhën • Sigurohuni që fëmija ka të paktën një shok/shoqe
<p>Aftësi komunikuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lejojeni fëmijën të jetë pjesë aktive e bashkëbisedimeve • Inkurajojeni të shprehë siç duhet nevojat, pikëpamjet, dhe ndjenjat të cilat duhen vlerësuar seriozisht • Mbani kontaktin me sy • Tregoni interes për çfarë tregon dhe flet fëmija • Tregohuni i sigurtë, por edhe i ndjeshëm ndaj të tjerëve • Mos paragjykoni • Mos e ngrini zërin dhe mos bërtisni • Vlerësojeni shpesh fëmijën • Bëjini kërkesa të thjeshta

04

**ROLI I PRINDËRVE,
VËLLEZËRVE DHE
MOTRAVE NË
PROMOVIMIN E
RUTINAVE
TË QËNDRUESHME
NË SHITËPI**



PLANI DITOR

Para orës 9
në mëngjes

Zgjimi

Lahemi, vishemi, hamë mëngjesin dhe rregullojmë krevatin

09:00 - 10:00

Shëtitja e mëngjesit

Bëjmë një shëtitje me një familjar, ndërsa gjatë ditëve me shi bëjmë joga.

10:00 - 11:00

Koha për mësim

ASNJË PAJISJE ELEKTRONIKE

Kryejmë lojëra dhe veprimtari ndërvepruese të ndryshme me prindin për zhvillimin gjuhësor, matematikor, aftësitë për jetën dhe të menduarit kritik.

12:00

Dreka

12:30

Ndihmë në punët e shtëpisë

- a) Fshijmë pluhurat nga tryeza dhe karriget
- b) Fshijmë pluhurat nga dyert dhe mobiliet.
- c) Kujdesemi për lulet
- d) Rregullojmë raftin e librave.

01:00 - 02:30

Ora e shtendosjes

Lexojmë, bëjmë lojëra me formuese (puzzle), flemë gjumë

02:30 - 04:00

**Koha për
mësim**

Shohim emisione, shfaqje për fëmijë në televizor; bëjmë lojëra elektronike ose luajmë me lodra

04:00 - 05:00

**Veprimtari në
ajër të pastër**

Bëjmë lojëra në natyrë, shëtitim, ngasim biçikletën, etj.

05:00 - 06:00

Darka

Shohim emisione, shfaqje për fëmijë në televizor; bëjmë lojëra elektronike ose luajmë me lodra

06:00 - 08:00

Kohë e lirë

Ndjekim emisione për fëmijë në televizor ose radio

08:00

**Koha për
gjumë**

Për të gjithë fëmijët

09:00

**Koha për
gjumë**

Fëmijët që ndjekin rutina nuk janë konfliktuale

TË DASHUR PRINDËR,

- Çdo ditë zgjohuni në të njëjtën orë dhe bini për të fjetur në orarin e përshtatshëm.
- Mos vendosni objektiva tepër ambicioze
- Shfrytëzoni kohën e mjaftueshme për të përgatitur planin e veprimtarive. Ndonëse në pamje të parë mund të mos jetë shumë domethënëse, ky plan do ta thjeshtësojë organizimin e ditës.
- Ky planifikim ndihmon fëmijën tuaj të krijojë rutinë dhe të ketë siguri dhe informacione mbi ato që do të bëjë gjatë ditës. Të dy këta faktorë janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës.
- Planifikoni veprimtari të përbashkëta me familjen dhe fëmijët (flisni dhe punoni së bashku për të vendosur rregull me fëmijët adoleshentë dhe përgatisni planin për fëmijët më të vegjël.) Planin vendoseni në një vend të dukshëm, shpjegojani dhe sigurohuni që fëmija i kupton dhe i pranon pritshmëritë tuaja.
- Mos i ndryshoni oraret e punës dhe të veprimtarive.
- Gjeni hapësirën e nevojshme për të punuar nëse po punoni nga shtëpia; krijoni “zyrën - vendin tuaj të punës” dhe e metodë gjë duhet të përdoret edhe për fëmijët nëse shkojnë në shkollë.
- Hani në oraret e përhershme.
- Nëse keni fëmijë të vegjël, mos i planifikoni veprimtaritë me kohëzgjatje të gjatë, por të shkurtër (veprimtari 30-minutëshe)
- Ju e njihni më mirë fëmijën tuaj, ndaj jeni ju personi që mund të përgatisni planin bazuar tek ato veprimtari që fëmija pëlqen më shumë dhe te koha që ai mund të kalojë duke kryer një veprimtari të caktuar. Kombinoni veprimtaritë që fëmija mund ti t'i realizojë më vete me veprimtaritë e përbashkëta me persona të tjerë.
- Kufizoni përdorimin e pajisjeve digjitale (telefona celularë, celularë inteligjentë, tabletë, kompjutera). Përdorini në mënyrë të tillë që të konsiderohen mjet dhe për një kohë të caktuar ose përdorini vetëm kur

janë të nevojshëm (vetëm kur keni një takim apo bisedë pune ose kur jeni tërësisht të lodhur).

- Nëse fëmija nuk fle pasdreke, planifikoni “orën e shtendosjes”.
- Është e rëndësishme që ju si prindër të qetësoheni pasi keni punuar gjatë ditës (vendosni ju kohëzgjatjen e pushimit që ju nevojitet. Gjatë kësaj kohe, fëmija mund të luajë, të lexojë në qetësi ose të bëjë detyrat e shtëpisë. Ju e njihni vetë fëmijën tuaj, prandaj zgjidhni një veprimtari që i pëlqen (sugjeroni veprimtari të qetë, lojë me puzzle, shkrim në ditar, etj). Në fillim mund të jetë e vështirë, por duke e bërë çdo ditë mund të përmirësoheni dhe minutat mund të vijnë duke u shtuar. Ashtu si prindërit e tyre, edhe fëmijët kanë nevojë për qetësi. Nëse kjo është e rëndësishme për ju vendoseni si prioritet me kufij të qartë. “Çfarë do të bëni gjatë orarit të shtendosjes? Asgjë; do të kënaqem; do të pushoj.” Prindërimi pa pushim, pa qetësi ndërkohë që ju përgjigjeni kërkesave të fëmijës suaj mund të jetë shumë i lodhshëm, veçanërisht me fëmijë të vegjël. Është shumë mirë të krijoni mundësi për të pasur kohë për veten tuaj apo për të pushuar. Mos u shqetësoni për rrëmujën, pasi pastrimi i shtëpisë mund të presë.
- Përfshijini fëmijët në punët e shtëpisë që janë të përshtatshme me moshën dhe aftësitë e tyre. Veprimtaritë e përbashkëta janë të rëndësishme për fëmijët, sepse ndihmojnë në krijimin e ndjenjës së përkatësisë dhe rrisin ndjesinë e të qenit i dobishëm.
- Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të krijuar rutinën e leximit të librave së bashku, ku të gjithë familjarët kalojnë kohë duke lexuar secili librin e vet.
- Një veprimtari e përbashkët është ndjekja e një filmi në mbrëmje të gjithë së bashku
- Tregohuni fleksibël. Mos iu përmbani verbërisht një veprimtari të planifikuar, pasi lejohet ta ndryshoni. Nëse fëmija po argëtohet me një lojë, mos e ndërpritni për të vetmen arsye se plani dikton “orën për të konsumuar fruta”.
- Kjo është një kohë e shkëlqyer për ta kaluar me fëmijën në mënyrë që t'i mjeshtërojë aftësitë e lojës, nëse nuk i ka përvetësuar tashmë. Filloni ta motivoni dhe ti sugjeroni: “A mund të organizosh një festë për dinozaurin tënd?”
- Kufizoni përdorimin e pajisjeve elektronike, celularëve inteligjentë, tabletëve, etj., pasi mund ta shpërqendrojnë fëmijën. Këtë gjë mund ta bëni duke dhënë shembull personal duke mos e kaluar kohën me celularë inteligjentë ose tabletë.

MESAZHET KRYESORE

TË DASHUR PRINDËR

- Fëmijët janë e ardhmja
- Ruani fëmijët dhe veten tuaj duke ndjekur masat kundër COVID-19
- Roli i prindit në mbështetjen e fëmijës për të nxënë është i domosdoshëm

Ky botim është prodhuar nga Save the Children SHBA, përshtatur në shqip dhe printuar nga Save the Children në Shqipëri.

TIRANË, 2020

Ky botim publikohet në kuadër të projektit “Asnjë fëmijë të mos mbetet pas në shkolla dhe kopshte gjithëpërfshirëse” i mbështetur dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me IPSED dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatës Save the Children si burim.

Pikëpamjet e autorit të këtij botimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Save the Children.



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840 / 4 2261929

✉ info.albania@savethechildren.org

🌐 <https://albania.savethechildren.net>

f [Savethechildrenal](#)

🐦 [SaveChildrenAlb](#)

📷 [savethechildrenalbania](#)